



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 16.5.2013, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: prof.dr. Isa Mustafa, kryetar i Komunës, dr. Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Ismail Kasumi, Musli Mehaj, Hetem Kupina, Avdush Dobratiqi, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Valon Hiseni, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Fetah Salihu, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Shefki Gashi, Shefqet Sylejmani, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Shemsi Veseli, Skënder Reçica, Liridon Restelica, Besa Halimi – Zagragja, Lumnie Rama, Astrit Hasani, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Besa Rafuna, Kimet Zeqa, Feti Mehdiu, Sadri Ramabaja, Afërdita Veliu dhe Engin Beyoglu.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE – së, të INPO-së dhe të mjeteve të informimit.

Mbledhjen e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin me rendin e ditës, **Shefqet Sylejmani** i njoftoi të pranishmit se më 27 prill të këtij viti, me vendimin e Kryesisë së degës, dega e AAK-së Qendra e Prishtinës, ka kaluar në LDK, edhe unë si kryetar i saj. Duke qenë se isha edhe kryetar i GP të AAK-së, jap dorëheqje nga kjo pozitë.

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se edhe Shefki Gashi, ish-shef i GP të LDD-së, i bashkohet GP të LDK-së.

Lidhur me rendin e ditës, **Feti Mehdiu** bëri një sugjerim lidhur me pikën e shtatë. Aty ku thuhet “Qytetar nderi i Komunës së Prishtinës”, mjafton të jetë “Qytetar nderi i Prishtinës”.

Kryesuesi gjithashtu tha se pika e gjashtë e rendit të ditës “Propozimvendimi për garanci të borxhit”, hiqet nga rendi i ditës, pasi që kemi nevojë t’i bëjmë edhe disa analiza të tjera.

Me heqjen e pikës së gjashtë nga rendi i ditës, u konstatua se njëzëri miratohet ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë;
2. Propozimvendimi për miratimin dhe lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit zhvillimor komunal për periudhën 2013 - 2022;
3. Propozimvendimi për dhënien e Qendrës Kulturore Rekreative në Gërmi në shfrytëzim të përkohshëm NPL "Sport Marketing" SH A në Prishtinë;
4. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve NPL "Sport Marketing" SH A në Prishtinë;
5. Raporti për arkëtimin, shpenzimet dhe investimet në periudhën 1 janar - 31 mars 2013;
6. Propozimvendimi për shpalljen e z. Lulzim Basha, Kryetar i Bashkisë së Tiranës, Qytetar nderi i Komunës së Prishtinës;
7. Pyetje dhe përgjigje;
8. Të ndryshme.

Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin dhe lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit zhvillimor komunal për periudhën 2013-2020, kryesuesi hapi diskutimin.

Behgjet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtje së Mjedisit, tha se me Ligjin për planifikim hapësinor, është paraparë hartimi i planeve rregulluese, në kompetencën komunale edhe plani zhvillimor komunal. Plani zhvillimor komunal është niveli më i lartë i planifikimit nga kompetenca e pushtetit lokal, përkatësisht Kuvendit të Komunës. Bazuar në këtë dispozitë ligjore, Kuvendi i Komunës, me Vendimin nr. 01-35-490, të datës 12.3.2009, ka nxjerrë Vendimin për fillimin e hartimit të Planit zhvillimor komunal. Në bazë të këtij vendimi, pra nga kompetencat që rrjedhin nga ligji dhe ky vendim, Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka hartuar detyrat rojektuese, me të cilat është kërkuar ofertuesi, përkatësisht kompania për hartimin e Planit zhvillimor komunal.

Fatima Alanja, përfaqësuese e kompanisë "Politeknika", tha se firma jonë, në bashkëpunim me "Art-Dizajn", si konzorcium, kemi hartuar Planin zhvillimor të Prishtinës. "Politeknika" është një firmë në Itali me rreth 200 teknikë ose të punësuar, që merret me projekte komplekse, dhe një grup specialistësh që janë mësuar të punojnë bashkë. Ajo, në mënyrë elektronike, bëri prezantimin e disa komponenteve kryesore të këtij plani.

Torsen Lang, përfaqësues nga "Politeknika", në pika të shkurtra prezantoi atë që parasheh plani lidhur me rregullimin e transportit publik në komunë.

Bujar Demjaha, përfaqësues i kompanisë projektuese “Art-Dizajn”, gjithashtu bëri prezantimin e këtij plani, duke komentuar kryesisht për zonat rurale.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë propozimvendim të Projektplanit zhvillimor komunal 2013-2022. Disa nga ne kemi marrë pjesë në debate dhe punëtori, që janë organizuar nga drejtoria për këtë projektplan. Në hartimin e këtij plani kontribut të mirë kanë dhënë edhe anëtarët e KPF-së dhe shefat e GP-ve. GP i LDK-së vlerëson punën e mirë të kompanive përfituese për hartimin e këtij projektplan. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të këtij plani, kemi vërejtur disa gabime në shkrimin e toponimeve, emërimeve dhe gabime të tjera teknike. Ne kërkojmë që në draftin final, të përmirësohen të gjitha këto, por edhe ato që mund të dalin nga diskutimet publike. Ne do ta përkrahim dhe e votojmë.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se edhe ne e kemi lexuar dhe analizuar, por ky plan zhvillimor neve na duket që është aq i përgjithshëm, sa lirisht mund të thuhet vetëm t’ia ndërrojmë emrin dhe lirisht mund ta përdorin shumë qytete të tjera si në Kosovë, ashtu edhe jashtë Kosovës. Në këtë plan përmenden disa gjëra, si p.sh. lidhja hekurudhore, ku thuhet se do të aftësohet lidhja e vjetër, kur ne e dimë që ajo duhet të largohet nga qendra dhe të qitet në periferi. Kemi dhënë kryesisht vërejtje rreth fshatrave të Gollakut, ku është një pjesë rurale, e cila përmendet vetëm si turizëm malor, ndërsa në asnjë plan rregullues apo në asnjë plan zhvillimor nuk hyhet në detaje se si të studiohet ajo pjesë, dhe në bazë të karakteristikave të fshatrave të jepet një shembull se si duhet të zhvillohet ajo pjesë atje. Unë kisha dashur që në këtë plan zhvillimor të mos shoh slajde, apo skena të qyteteve të tjera, por të shoh se si duket Prishtina.

Vërejtje pati edhe në stafin punues të këtij projekti, ku nuk ka inxhinier të ngrohjes, kur e dimë se Prishtina shpëtimin e ngrohjes e sheh prej kogjenerimit nga termocentralet në Obiliqi, pra as nuk ka ekip i cili ka punuar, as nuk parashihet këtu se çka do të bëhet apo si do të bëhet kogjenerimi i ngrohjes në Prishtinë. Me të gjitha vërejtjet, të cilat besoj se do të jepen edhe nga qytetarët, ne pranojmë që ky projektplan të shkojë në diskutim publik.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, fillimisht i përshëndeti përfaqësuesit e kompanive projektuese dhe e vlerësoi gjithë punën dhe angazhimin që e ka bërë ky konzorcium për punën e deritashme. Sa i përket këtij projektplan, tha se ky është një projektplan shumë voluminoz, por që i mungojnë edhe disa gjëra konkrete.

Ky projektplan zhvillimor komunal nuk përmban, ose të them pjesërisht e përmban analizën e gjendjes ekzistuese me diagnostifikimin e problemeve reale, ku si rezultat i kësaj do të kemi alternativa jo të sakta dhe nuk do të arrihet zgjidhje e mirë në planet e mëvonshme të zhvillimit urban dhe planeve rregulluese që do të jenë urbane. Nuk ka përgjigje lidhur me një nga problemet më të rënda, rreth ndërtimeve të egra, nuk jepet zgjidhja konkrete pragmatike e rrjetit primar të infrastrukturës teknike, të korridoreve të tyre, uji, kanalizimi, energjia elektrike, PTT-ja, ngrohja etj. Flitet kryesisht për standardet çfarë duhet t’i ketë, por nuk flitet për specifikat çfarë i ka faktikisht këtu komuna e Prishtinës, dhe cilat janë alternativat që do të orientonin drejt përmirësimit ose zgjidhjes së atyre mungesave dhe shqetësimeve që i kanë qytetarët e komunës së Prishtinës. Nuk ka të dhëna mbi numrin e nevojshëm të objekteve arsimore me sipërfaqe sipas lokacioneve, kur e dimë se në disa lagje nuk ka shkolla të mesme, si p.sh. lagja “Kodra e

Trimave" dhe në këtë plan nuk thuhet asnjë fjalë. Nuk ka asnjë tregues urban të kualitetit jetësor për gjendjen ekzistuese në raport me gjendjen e ardhshme. Në raport të planifikuar, mungon modeli mbi politikat e menaxhimit të tokës ndërtimore, mungon analiza e kostos, që është shumë e rëndësishme e realizimit të planit zhvillimor komunal etj. Nëse flasim për ndërtimet e pakontrolluara, pashmangshëm kanë pasur ndikim në mjedis dhe shëndetin publik, e në këtë dokument nuk është konstatuar gjendja në hapësirë me këto veprime. Po ashtu nuk është dhënë asnjë propozim se si të sanohen hapësirat e caktuara me këto veprime. Me qëllimin më të mirë, në emër të GP, i dhamë këto sugjerime dhe rekomandime që konzorciumi t'i ketë parasysh, në mënyrë që pas debatit publik të inkorporohen në projektin final.

Astrit Hasani, në emër të GP të AAK-së, tha se sa i përket Planit zhvillimor komunal e përhëndes iniciativën që të ketë shtigje për biçikleta, gjë që është shumë e nevojshme, duke pasur parasysh trafikun e ngjeshur në komunën tonë. Do të duhej të parashiheshin më shumë fusha sportive në funksion të rinisë së Prishtinës. Propozoj që në ato vende ku ka beton, si p.sh. rruga "B", pastaj tek ura në lagjen "Lakërishta", të vendosen lule, ashtu siç praktikohet në shumë vende të Evropës.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, fillimisht e përgëzoi hartuesin e këtij projekti për zhvillimin e Prishtinës. Lidhur me këtë tha se ka gjëra që duhet në ndërkohë të plotësohen dhe të analizohen, dhe të bëhen edhe disa korrigjime tekstuale. U pajtua me konstatimin se duhet të ngrihet cilësia në arsim dhe kjo mund të rritet në qoftë se i qasemi pak më ndryshe arsimit, sepse sistemi arsimor është mjaftë i ndërlikuar.

Te trashëgimia kulturore, është konstatuar se Prishtina ka shumë pasuri, të identifikuar dhe të pidentifikuar, pra presim që të bëhen hulumtime arkeologjike historike etj. Këtë trashëgimi kulturore duhet ta ruajmë e mos të shkojmë më me dëmtimin apo zhdukjen e atyre objekteve që i ka pasur Prishtina, siç kanë qenë shumë burime të ujit, shumë çezma ose në dëmtimin e atyre objekteve apo me ndërrimin e destinimit të objekteve, siç është Hamami i Prishtinës etj.

Në emër të GP të PD-së, propozoi që ish-çezma para ish-hotelit "Iliria", e cila u zbulua si një burim i kulturës, si një fragment i një pjese të kaluar historike, edhe pse është e mbuluar, të zbulohet përsëri. Njëherësh sugjeroi që me forca të përqendruara, të orientuara mirë, të analizuar dhe me angazhimin edhe të ekspertëve të tjerë, të mundësohet edhe realizimi i projektit për ngrohjen e qytetit. Sa i përket pjesës rurale, shprehu mendimin se ajo nuk është trajtuar mirë, andaj dhe nuk mund të zhvillohet si duhet.

Të gjitha këto vërejtje dhe sugjerime duhet të na shërbejnë për të nxjerrë ndonjë mësim, në mënyrë që deri më 2022 ta sjellim Prishtinën në njëfarë shkalle pak më të mirë të cilësisë së jetës së qytetarëve të saj.

Afërdita Veliu, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV), tha se edhe grupi ynë parlamentar e ka analizuar këtë projektplan dhe, si forcë politike, jemi të interesuar për zhvillimin dhe prosperitetin e kryeqytetit dhe mirëqenien e qytetarit të Prishtinës. Megjithatë te ky plan që na është prezantuar sot, ne kemi parë kornizat premtuese zhvillimore, mirëpo mendojmë se ky dokument është dashtë të hartohet shumë më herët, së paku para 8 vitesh, dhe jo pikërisht sot, i cili më tepër na tingëllon si një dokument në

shërbim të fushatës. Sido që të jetë, ne e përkrahim këtë projektplan dhe e përshëndesim punën e konzorciumit që e kanë bërë për hartimin e këtij projektplani, ndërsa për mangësitë që i kemi vërejtur në këtë dokument dhe vërejtjet tona, ne do t'i dorëzojmë me shkrim.

Kryesuesi tha se hartimi i këtij projektplani nuk është për fushatë, por është obligim ligjor dhe ne e kemi përcjellë saktë miratimin e ligjeve në nivelin qendror dhe konform tyre jemi duke vepruar.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, tha se ne e vlerësojmë punën profesionale të konzorciumit "Politeknika" dhe "Art-Dizajn". Meqë ky projektplan do të shkojë në diskutim publik, e përkrahim, e pastaj me vërejtjet dhe sugjerimet e qytetarëve të na kthehet për votim versioni final.

Flamur Shala përshëndeti konzorciumin nga këto dy kompani, i cili e ka bërë punën e tij të madhe në hartimin e Planit zhvillimor për kryeqytetin. Nëse mendojmë se në këtë plan nuk kemi paraqitje të gjendjes aktuale, gabojmë, sepse pikërisht në ato faqet e para të planit janë të paraqitura këto dhe absolutisht ne e kemi një gjendje jashtëzakonisht reale në lidhje me gjendjen në Prishtinë.

Çështja e dytë, është se ky plan ka dalë si një politikë zhvillimore e Prishtinës, e kryeqytetit, e Komunës, pra si një politikëbërje, për të cilën ne duhet të marrim vendim. Në kuadër të kësaj komuna ka përcjellë të gjithë atë procedim dhe në kuadër të ligjit është duke u proceduar. Nëse themi se jemi vonuar, ne jemi vonuar për diçka më shumë se ky plan zhvillimor. Jemi vonuar duke mos e pasur Ligjin për kryeqytetin, i cili po të ishte tani ai ligj, sigurisht që do të na shkonte për shtati të gjithëve ta bëjmë harmonizimin edhe më të madh të këtij plani.

Nëse hyjmë në detaje të këtij plani, mendoj se është një plan i strukturuar mirë. Me hartimin e Planit zhvillimor urban, mendoj se do të jetë më materializues për hapësirën, por edhe planet rregulluese të cilat do të vijnë në të ardhmen dhe do të zbatohen ose do të hartohen mbi bazën e këtij plani.

Marrë të gjitha këto parasysh, bën që Prishtina në 10 vitet e ardhshme t'i fitojë kornizat e një zhvillimi të mirë prej një kryeqyteti që mëton të jetë një kryeqytet metropolitan. Vizioni për Prishtinën, vizioni kryeqytet i një shteti të ri, kryeqytet i të rinjve dhe me një hapësirë cilësore, do t'i jepet vetëm nga ne të gjithë së bashku, pa menduar shumë në politikë, por duke menduar në politika, sepse politikat janë ato që e bëjnë një kryeqytet të zhvilluar.

Milazim Vitia, lidhur me këtë plan bëri dy vërejtje, për të cilat tha se aty ku ceket se kufizimi i Prishtinës, në përfundim kufizohet me Kamenicën (Dardanën), është gabim, andaj duhet të jetë: "në lindje kufizohet me Kamenicën (Dardanën)". Vërejtje edhe te sistemi i pompimit të ujit, te emërtimi se atje nuk është Shashkocv, por është Shajkocv. Kur ishte fjala te ekspertët, mendoj se duhet të ketë ekspertë sa u përket fushave të ndryshme. Me që është plan zhvillimor, në zonat rurale duhet të iu tregohet atje fermerëve se çka mbillet, çka kultivohet në atë pjesë atje. Meqë pjesa lindore dhe verilindore e Prishtinës është kryesisht grup i vargmaleve rodope, atje ku është kryesisht e pasur me xehe dhe ka miniera, siç është ajo e Artanës, me që acidet që dalin nga ajo minierë e ndotin lumin, do të duhej menduar për riciklimin e ujit që del nga ajo minierë.

Tefik Mehmeti tha se kjo është një pikë e rëndësishme për banorët e komunës së Prishtinës, ku Prishtina e ka një specifikë të veçantë.

Në fillim të përshkrimit janë dhënë arsyetimet e nevojshme dhe vështirësitë që i ka hasur kompania rreth shënimeve të numrit të banorëve, si dhe elementet tjera të nevojshme për përgatitjen e këtij materiali.

Është filluar me përshkrimin e gjendjes ekzistuese, ku duhet të kemi kujdes nganjëherë ka edhe gabime që duhet të përmirësohen, si p.sh. përshkrimi i objektit kulturor, thuhet bibliotekë universitare, duhet të jetë së pari bibliotekë kombëtare, sepse është një institucion shumë i rëndësishëm i çdo vendi. Gjithashtu thuhet rrjeti hekurudhor ekzistues me Mal të Zi, që faktikisht nuk ka Kosova rrjetë ekzistues hekurudhor me Mal të Zi. Ka dhe disa vërejtje të tjera që duhet përmirësuar, ku janë disa tabela apo figura që vështirë mund të lexohen. Kërkoj që herën tjetër këto të jenë të lexueshme, sepse është vështirë për t'i definuar. Nganjëherë përshkruhen disa gjëra apo kompetenca që nuk i përkasin nivelit lokal, andaj duhet të analizohen mirë dhe përshkruhen se çka është në kompetencë të nivelit lokal. Meqë ky projektplan do të shkojë në diskutim publik, besoj se gjatë kohës sa do të jetë në diskutim publik do ta analizojmë edhe më shumë të gjithë dhe do të kemi kohë që vërejtjet t'i paraqesim dhe t'i përmirësojmë.

Sadri Ramabaja tha se po të ishte analizuar mirë ky plan në mbledhjen e KPF-së, nuk do të duhej t'i jepej viza që të na sillej kështu si është sot, dhe duke pasur parasysh me një pjesë të lëshimeve që i potencoi edhe kolegu, ta zëmë linja hekurudhore me Malin e Zi, disa lëshime elementare etj. Për të respektuar këtë kuvend, për të na respektuar edhe neve si anëtarë të këtij kuvendi, propozoj që të mos nxirret në diskutim publik, sepse i mungon korrektura dhe redaktura profesionale. Me këto çështje që po i potencoj, dua ta mbroj interesin, imazhin e Kuvendit dhe qytetit të Prishtinës. Mos t'u përcjellim qytetarëve dokument kështu si është, sepse ne si kuvendar do të dalim keq.

Kryesuesi tha se ky projektplan do të dalë në diskutim publik pas një jave dhe do të jetë në dispozicion për dy muaj. Ka vërejtje në emërtime, toponime etj., të cilat besoj se do të përmirësohen. KPF-ja e ka trajtuar tri herë dhe konsiderojmë se është trajtuar mirë.

Njëzëri u miratua Vendimi për miratimin dhe lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit zhvillimorë komunal për periudhën 2013 - 2022.

Pika e tretë dhe e katërt

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien e Qendrës Kulturore Rekreative në Gërmi në shfrytëzim të përkohshëm NPL "Sport Marketing" SHA në Prishtinë dhe Propozimvendimin për lejimin e mjeteve, ndërmarrjes publike lokale "Sport Marketing" SHA në Prishtinë, Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, tha se NPL "Sport - Marketing" ka kërkuar dhënien e Qendrës Kulturore Rekreative në Gërmi në shfrytëzim të përkohshëm. Qëllimi i shfrytëzimit të përkohshëm të qendrës nga ana e kësaj ndërmarrjeje është funksionalizimi i Qendrës Kulturore Rekreative në Gërmi, me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve të edukimit, kulturës dhe rekreacionit.

Sa i përket Propozimvendimit për lejimin e mjeteve ndërmarrjes publike lokale, "Sport - Marketing", tha se këto mjete janë të siguruara nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve dhe jepen me qëllim të përdorimit për pajisje të kuzhinës, interier për restorant, mobile për akomodim dhe fjetje.

Musli Meha, në emër të GP të LDK-së, tha se ne e kemi analizuar dhe jemi pajtuar që këto dy pika të miratohen, me qëllim sa më të mirë dhe që sa më parë të funksionalizohen dhe të shfrytëzohet ky objekt shumë i rëndësishëm për qytetarët e Prishtinës me rrethinë. I japim përkrahje dhënies së kësaj qendre në shfrytëzim për dhjetë vjet dhe dhënien e mjeteve në vlerë prej 100.000 €.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se i përkrahim propozimvendimet për dhënien e objektit në shfrytëzim dhe për lejimin e mjeteve financiare.

Besa Halimi - Zagragja, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe ne jemi shumë të kënaqur me iniciativën e funksionalizimit të qendrës rekreative, por kisha dashur që fillimisht kjo shoqëri, e cila ka marrë përsipër ta bëjë këtë funksionalizim, t'i ofrojë këtij Kuvendi edhe një plan pune, përmes të cilit do duhej ta shihnim misionin e saj edukativ dhe kulturor, d.m.th. paraprakisht është një kërkesë e tillë.

Sa i përket lejimit të mjeteve, kërkojmë që patjetër të përcillet nga Auditori i Përgjithshëm, që të na jepen të gjitha detajet, në mënyrë që të shohim se si po funksionon gjithçka.

Mejreme Berisha, në emër të GP të AAK-së, shprehu mendimin se këto dy propozimvendime janë mjaft të rëndësishme për kryeqendrën tonë dhe jemi për miratimin e tyre.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, përkrahu miratimin e të dy këtyre akteve, por një gjë që e ka qenë edhe më herët, se dhënia në shfrytëzim për 10 vjet, në çoftë se nuk e ndajmë në dy pjesë, mendoj se ka më shumë mundësi të keqpërdoret, prandaj jemi të mendimit që të jetë dhjetë vite, por me një llogari në krye të pesë viteve.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje(VV), tha se meqë është ndërmarrje publike dhe monitorohet nga Kuvendi i Komunës, do të duhej që një pjesë e atyre pronave private, që janë tjetërsuar në mënyrën më barbare të mundshme gjatë viteve të fundit, t'i kthehen këtyre ndërmarrjeve publike. Ne e kemi shqyrtuar, e mbështesim dhe e votojmë.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, shprehu përkrahje për miratimin e këtij propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm ndërmarrjes "Sport - Marketing", për dhjetë vjet, në mënyrë që të funksionalizohet Qendra Rekreative në Gërmi, me qëllim të avancimit për zhvillimin e aktiviteteve të edukimit, kulturës, sportit dhe rekreacionit. Njëherësh përkrahim edhe lejimin e mjeteve financiare për këtë ndërmarrje.

Liridon Restelica tha se e kemi shqyrtuar këtë pikë dhe jemi pajtuar që këtë qendër ta marrë në mbikëqyrje ndërmarrja publike, por a është analizuar se a ka të drejtë ndërmarrja që këtë objekt ta japë me qira te pala e tretë? Nuk duhet lejuar që ky objekt t'i jepet palës së tretë.

Kryesuesi tha se ky objekt i jepet në menaxhim ndërmarrjes “Sport - Marketing” dhe assesi nuk lejohet që t’i jepet në shfrytëzim me qira palës së tretë.

Njëzëri u miratuan Vendimi për dhënien e Qendrës Kulturore Rekreative në Gërmi në shfrytëzim të përkohshëm NPL “Sport - Marketing” SHA në Prishtinë dhe Vendimi për lejimin e mjeteve NPL “Sport - Marketing” SH A në Prishtinë.

Pika e pestë

Lidhur me Raportin për arkëtimin, shpenzimet dhe investimet në periudhën 1 janar - 31 mars 2013, në pika të shkurtra informoi Xhelil Bektashi, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, duke thënë se ky është një raport mbi arkëtimin dhe shpenzimet për periudhën e parë të këtij viti, që është bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive. Në raport e kemi përfshirë pjesën e parë të buxhetit, pjesëmarrjen që përbëhet nga të hyrat vetanake dhe nga grantet, nga granti i përgjithshëm, granti specifik për arsim dhe granti specifik për shëndetësi. Këto të dhëna janë pasqyruar në mënyrë kronologjike në këtë material.

Tefik Mehmeti në emër të GP të LDK-së, tha se ky raport na jep një pasqyrë mbi rrjedhën e parasë si në të hyrat, ashtu edhe në shpenzimet. Vlerësojmë se ky është një raport i mirë, i cili paraqet gjendjen ekzistuese, ku shihet se është në kuota normale në afrime dhe tejkalime sipas situacioneve.

Dihet se Prishtina gjithëherë ka të hyra vetanake shumë të mira, merr pjesë me rreth 40 % të të hyrave të përgjithshme vetanake në nivel të Kosovës. Po të merret parasysh kjo përqindje, atëherë edhe ndarja e buxhetit të përgjithshëm duhet të jetë diku me këtë përqindje. Lidhur me shpenzimet, e kemi cekur edhe më parë se tremujori i parë i ka specifikat e veta, sidomos tek investimet kapitale, andaj edhe përqindjet janë më të ulëta. Janë disa faktorë që ndikojnë në arkëtimin dhe në investime, siç janë: alokimi i buxhetit, procedurat e tenderimit, afatet kohore, por edhe përkundër këtyre problemeve, mund të them se rrjedha e parasë në këtë tremujor është e mirë në të gjitha drejtimet, andaj edhe grupi ynë parlamentar e përkrah këtë raport.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se ne e kemi analizuar këtë material dhe kemi ardhur në përfundim se është një lloj informate për këtë tremujor, më tepër rreth punës së drejtorisë përkatëse.

Ndoshta një vërejtje ose një sqarim kisha kërkuar nga drejtori, ku në raport thuhet se të hyrat nga gjobat në trafik 6.80 % realizimi, a thua do të planifikohen edhe këto, besoj që gjoba nuk duhet të jetë me një përqindje të planifikuar se sa parasheh për t’i fituar.

Kryesuesi tha se të hyrat nga gjobat në trafik janë një kategori që është e përcaktuar te të hyrat vetanake.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, shprehu mendimin se edhe pse alokimi i mjeteve buxhetore është bërë në fund të janarit, prapë se prapë jap një dozë skepticizmi se shanset për t’u respektuar pasqyra e rrjedhës së parasë gjithëherë po

vihet në pikëpyetje, dhe këtë duke pasur parasysh shpenzimet kaq të ulëta prej 1.4% , pra është një indikator i performancës së menaxhimit të dobët, përkundër faktit se mjetet kanë ekzistuar. Ne nuk mund të japim një opinion të saktë në bazë të raportit, për të ditur se sa është i kënaqshëm shpenzimi në mallra dhe shërbime.

Tek shpenzimet komunale, në bazë të raportit vërehet se janë në trend të mirë të shpenzimeve. Subvencionet, transferet, në bazë të raportit shihet se te nga kjo kategori ekonomike janë shpenzuar 40% të planifikimit vetëm për tremujorin e parë, dhe ky është një indikator që tregon se prapë këtu, megjithëse është e kënaqshme, planifikimi nuk mund të jetë real karshi nevojave.

Shpenzimi i buxhetit për 10%, tregon një shpenzim tejet të ulët karshi planifikimit, edhe përkundër faktit se raporti tregon se alokimi i mjeteve është bërë me vonesë dhe kohës së papërshtatshme të dimrit, siç potencohet në raport. Nëse përqindja e buxhetit të shpenzuar bëhet në bazë të parametrave të planit, atëherë në bazë të raportit mund të konstatoj se në tremujorin e fundit do të shohim se është bërë traditë, në një farë forme, që shpenzimi, sidomos në investime kapitale, të bëhet mbi 40%, që tregon se nuk ka planifikim të mirëfilltë si duhet dhe menaxhim të parasë publike.

Mejreme Berisha, në emër të GP të AAK-së, tha se duhet që ta kemi parasysh se alokimi i buxhetit në tremujorin e parë po bëhet në një kohë krejt tjetër, në stinën e dimrit, andaj edhe besoj që të gjitha këto shpenzime i kemi të parapara.

Njëzëri u miratua Raporti për arkëtimin, shpenzimet dhe investimet në periudhën 1 janar - 31 mars 2013.

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimvendimin për shpalljen e z. Lulzim Basha, Kryetar i Bashkisë së Tiranës, Qytetar nderi i Komunës së Prishtinës, Kryesuesi fillimisht tha se e përkrahim propozimin e z. Mehdiu, që të jetë "Qytetar nderi i Prishtinës". Lulzim Basha ka merita, sepse ky njeri nga viti 98 -99 ka punuar në Gjykatën për Krime të Luftës në Hagë dhe ka punuar në dosjen që është bërë për arrestimin e Milosheviqit, d.m.th. drejtpërdrejt në pjesën për Kosovë, si dhe ka ushtruar disa funksione të tjera të rëndësishme në periudhën 2000 - 2005 në Kosovë etj.

Sadri Ramabaja tha se edhe ne e kemi shqyrtuar këtë propozimvendim dhe nuk na rezulton se ka ndonjë meritë të veçantë që të shpallet Qytetar nderi. Ai është person, i cili një kohë është ndjekur penalisht për keqpërdorim të madh material në projektin "Rrugën e kombit", është përfolur edhe në Gjykatën e Hagës se një pjesë e ushtarëve tanë janë dëmtuar si rezultat i aktivitetit të tij etj., pra këto janë arsye të mjaftueshme që të rezervohemi për votim.

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Ramabaja, **Kryesuesi** dha sqarime shtesë.

Me shumicë votash, dy abstenime (Sadri Ramabaja dhe Afërdita Veliu), u miratua Vendimi për shpalljen e z. Lulzim Basha, Kryetar i Bashkisë së Tiranës, Qytetar nderi i Prishtinës.

**Pika e shtatë dhe e tetë
Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme**

Astrit Hasani, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale:

Pse nuk është rregulluar parkingu i veturave në lagjen “Dardania”, kur dihet që është pikësynim për dëmtimin e veturave në Prishtinë? Kërkoj që urgjentisht ky parking të rregullohet.

Naime Osmani shprehu shqetësim rreth moskthimit të përgjigjeve nga ana e Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, duke thënë se tek pas tre muajve më është kthyer përgjigje nga kjo drejtori, por nuk është cekur emri im që e kam bërë pyetje, dhe një përgjigje jo që mua nuk më konvenon, por në një mënyrë më ofendon mua edhe qytetarët e fshatit Besi. Mua më është kthyer përgjigja “Sa i përket kanalizimit te familja Mexhuani, vitin e kaluar e kemi dërguar për projektim dhe pasi është shpallur fituesi, ai nuk e ka nënshkruar kontratën dhe ka mbetur pa u përfunduar projekti, kurse me paramasë është e pa mundur një kanalizim të rregullohet”. Po ashtu edhe te Lagjja e Marollëve është kontest pronësor, gjë që nuk ka konteste, kam kërkuar që të dalë një grup i inxhinierëve edhe njëherë ta verifikoj rastin. Disa prej kërkesave, vetëm po i ceku që në një kohë kam thënë që nuk do të bëjë pyetje pasi që nuk më kthehen përgjigjet, por prapë po ndiej përgjegjësi ndaj qytetarëve me i përcjellë kërkesat e tyre.

Kam bërë kërkesa për trotuar, që është rruga me shumë rreziqe në fshatin Besi, po ashtu edhe përskaaj magjistrales Prishtinë – Podujevë afër shkollës së Besisë, brenda fshatit Besi ndriçim nuk ka, mbeturinat nuk mblidhen, po ashtu edhe nga qentë endacakë qytetarët janë të rrezikuar dhe shumë e shumë kërkesa të tjera, por këto kërkesa që i ceka janë shumë me prioritet.

Kryesuesi tha se ato projekte do të realizohen kur të parashihen me buxhet.

Rexhep Mustafa tha se neve na u dha një obligim për një informatë nga Trafiku Urban, në pika të shkurtra dua t’ju njoftoj se pas komunikimit apo lajmërimit të asaj informate në mjete të shtypit dhe në adresë të deputetëve. Kjo informatë nuk na është drejtuar neve si aksionarë e as Bordit të ndërmarrjes. Më 3 prill ne aksionarët kemi biseduar me menaxhmentin, por edhe përpara kemi biseduar me punëtorët e ndërmarrjes dhe asnjëherë këto nuk janë cekur, ata thirren në menaxhmentin e mëparshëm e më pak në menaxhmentin e tanishëm. Por, meqenëse është letër anonime, pa adresë, ne kemi pritur që do të dalë edhe ndonjë shkresë tjetër dhe do të na lajmërohet edhe njeriu, dhe ne nuk kemi mundur të marrim asnjë informatë tjetër, me përjashtim të asaj shkrese. Si komision i aksionarëve ne nuk e kemi marr parasysh atë shkresë, meqenëse nuk na është adresuar neve dhe nuk është adresuar në emër të ndërmarrjes.

Me rastin e shkresës kemi pas reagime shumë të mëdha nga kontraktorët që janë përmendur me emër dhe nga ish-drejtori i mëparshëm, i cili ka shprehur dëshirën, nëse ka nevojë, të vijë edhe para Kuvendit dhe të deklarojë rreth vërtetësisë. Ne këtë çështje e kemi mbyllur dhe e kemi lënë jashtë si të pa vlefshme.

Kryesuesi theksoi se edhe tek unë, por edhe te drejtori paraparak dhe operatorët kanë ardhur shkresa, përmes së cilave demantohen në përgjithësi shkrimet të cilat janë dhe ku janë apostrofuar, pra ato kanë qenë vetëm si informatë.

Sadri Ramabaja insistoi që informata e Komisionit të aksionarëve të Trafikut Urban të sillet me shkrim, për shkak se aty ka mjaft elemente që nesër mund t'i hyjnë në punë prokurorisë. Përmenden 51 000 € dhe insistojmë që të na sillet një informatë me shkrim rreth të gjitha atyre çështjeve të ngritura atje.

Ai parashtrori dy çështje:

1. Çështja lidhur me zyrën e LDK-së, që është ngritur para disa ditësh në Ulpianë në kuadër të objektit të Bashkësisë Lokale. Dua që të na jepet një shpjegim si është çështja. Në mjetet e informacionit e kemi lexuar, nuk e dimë saktësisht se është apo nuk është kjo e vërtetë, por do të ishte mirë që të informohemi këtu.
2. Çështja lidhur me mungesën e përgjigjes ndaj kryetarit të Bashkësisë Lokale të lagjes "Arbëria", të cilën e kemi parashtruar tash e katër muaj. Nuk po tregohet se me çfarë të drejte shfrytëzohet nga një shoqëri kulturore turke objekti i Bashkësisë Lokale dhe nuk lejohet që të kryhen aktivitetet e Bashkësia Lokale.

Nuk më është kthyer përgjigje mua, por nuk iu është kthyer përgjigje me shkrim as atyre që kanë parashtruar pyetje më parë, siç e obligon rregullorja. Kjo është hera e tretë që e përsërisë.

Kryesuesi tha se objekti ku është vendosur Dega e LDK-së në Ulpianë, nuk është i Bashkësisë Lokale, por është objekt i Ndërmarrjes Publike Banesore, me të cilën kam lidhur kontratë edhe paguaj qira për zyrë. Unë jam kryetarë i asaj dege, dhe ai objekt është marr me qira.

Aziz Pacolli bëri vërejtje lidhur me mirëmbajtjen e parkut Tauk-bahçe. Kanali në atë hapësirë kundërmon erë të rëndë, andaj kërkojmë që të pastrohen ato kanale. Gjithashtu kërkojmë që të ndërpritet rrjedhja e kanalizimeve të tjera që derdhen në atë kanal.

Shemsi Veseli ngriti tri shqetësimet në vazhdim:

1. Te objekti nr. 1 i kompleksi banesor "Dielli", në lagjen "Kodra e Diellit", nga një qytetar i pandërgjegjshëm është thyer shtylla e objektit, me qëllim të vendosjes brenda të një makine për pastrim kimik. Ende pa e marrë lejen e ndërtimit, të shfrytëzimit në të vërtetë, të bëhen aq ndryshime të mëdha aty në objektin ku jemi ne duke banuar, ky veprim vërtetë është shqetësues. Ndryshime ka edhe nëpër kulme, d.m.th. kur kanë filluar edhe tarraca të ndryshme dhe çështje të tjera.
2. Çështje tjetër është edhe shqetësimi i qytetarëve të lagjes "Ulpiana" për parkingun me qira, atje te "Fellini", ku përflitet se Ndërmarrja Publike Banesore e menaxhon këtë parking dhe dikujt ia ka dhënë me qira. Mendoj se ky parking është pjesë

përbërëse dhe përcjellëse e ndërtesave. Duhet të jetë një kujdes më i shtuar, sepse ka plot pjesë të qytetit të Prishtinës ku njerëzit e pandërgjegjshëm, për përfitimet e tyre personale, kanë uzurpuar, uzurpojnë dhe mbajnë në mbikëqyrjen e tyre parkingjet. Konsideroj se ato janë pjesë përbërëse e infrastrukturës përcjellëse të ndërtesës dhe është mirë që të hulumtohet kjo.

3. Çështja tjetër, të cilën e kam potencuar disa herë, është edhe çështja e largimit të kontejnerëve te spitali “Rezonanca”, sa tërhiqen pak, kthehen përsëri afër dritares së një qytetari, i cili edhe është i paralizuar. Kjo është e dhimbshme, andaj kërkoj inspekcioni që këtë ta kenë parasysh.

Çështje tjetër është edhe një informatë e marrë nga qytetarët e lagjes “Dardania”, ku dalja për garazhet e banorëve SU7/5 është uzurpuar nga qytetarja Arta Nallbani. Aty është adaptuar një hapësirë banimi, ku bodrumi shndërrohet në banesë. Edhe pas lajmërimit të rastit, ajo nuk e ka ndërprerë punën. Mosveprimi me kohë i organeve gjegjëse po krijon një terren të dyshimtë për të menduar se janë të korrumpuar, prandaj është mirë që të marrim masa, sepse është interesi i qytetarëve që të parandalohen këta njerëz të pandërgjegjshëm, të cilët në dëm të interesit publik pretendojnë të përfitojnë në aspektin personal.

Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Veseli, rreth parkingut në lagjen “Ulpiana”, **Kryesuesi** dha sqarime të nevojshme.

Shaip Hajrizi, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale:

Qytetarët e lagjes “Kolovica”, gjegjësisht afër rrugës “Afrim Abazi”, tash e dy vite kanë bërë kërkesë që të intervenohet në këtë rrugë, të paktën ajo të shtohet me zhavorr.

Pyetja tjetër ka të bëjë me rrugën Koliq – Dyz, ku qytetarët duan të dinë saktësisht kush e ka obligim ta shtrojë këtë rrugë, Ministria e Infrastrukturës apo Komuna, në gjatësinë prej gjashtë kilometrash, që lidhet me territorin e Podujevës.

Kryesuesi tha se rruga Koliq - Dyz është rrugë që lidh dy komunat edhe nuk është në kompetencë të komunës, por është në kompetencë të Ministrisë.

Ka projekte të përbashkëta që janë bërë, por ajo pjesë ka mbetur, prandaj nuk është vetëm e Komunës, sepse Komuna pa ndihmën e Ministrisë nuk mund ta kryejë atë punë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Sami Hamiti, ecc.i dipl.